

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Si të shmangni shpërthimin e pijeve të gazuara? Ja një truk i thjeshtë
ADRESA	https://www.cna.al/lifestyle/si-te-shmangni-shperthimin-e-pijeve-te-gazuara-ja-nje-truk-i-thjeshte-i474386
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:42:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 18:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d1df52bb3c6efd4da9d4d54dc20c8c19e6939f1816d9b2faff2ca3c4abd11eac
TEKSTI	25439f4b6069cd4529b9acd53c1f665a79b981f43d75ebb0863ff5aedbecaaf2
PAMJA	e049e7518404f3e08d8bfb432edc8dcae43fa1688511aada789248f2b9b6360e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	efdeca32b67e806d9d75297df5db65f3f6809fa0b803f58e0e9443c0aeb1db68
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	78d6084bfd6cb1be1efae0b014ade0ef1539709e636c33f39308264a405fee6e2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/efdeca32b67e806d9d75297df5db65f3f6809fa0b803f58e0e9443c0aeb1db68>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Si të shmangni shpërthimin e pijeve të gazuara? Ja një truk i thjeshtë



16 Shtator 2026, 20:40, Lifestyle CNA



Kushdo që ka hapur një kanaçe pijeje të gazuar pasi ajo është tundur ose ka rënë në tokë, e njeh skenarin: në momentin që hapet, pija del me vull dhe përfundon kudo. Por ekziston një mënyrë e thjeshtë për ta parandaluar këtë, dhe shpjegimi vjen nga shkencë.

Mjafton të imagjinoni një ditë të nxehtë, kur merrni një kanaçe të ftohtë nga frigoriferi ose nga çanta e piknikut. Nëse kanaça është lagur, ju bie nga dora ose është tundur gjatë transportit, mund të mendoni se nuk ka ndodhur asgjë serioze.

Por sapo të hapni kapakun, mund të përballeni me një shpërthim të papritur të pijes.

Arsyeja lidhet me dioksidin e karbonit, ose CO₂, që gjendet i tretur në pijet e gazuara.

Çfarë ndodh brenda kanaçes?

Kur një kanaçe me pije të gazuar tundet, fluskat e dioksidit të karbonit ndryshojnë pozicion brenda saj. Gazi shpërndahet në pjesë të ndryshme të lëngut dhe krijon kushte që, në momentin e hapjes, fluskat të dalin shumë shpejt në sipërfaqe.

Kur hapet kanaça, presioni bie papritur. Si pasojë, dioksidi i karbonit fillon të çlirohet dhe fluskat shtynjë lëngun drejt hapjes.

Rezultati është ai që të gjithë duam të shmangim: pija del me forcë dhe mund të përfundojë në rroba, tavolinë apo kudo tjetër përreth.

Truku: katër trokitje në kanaçe

Një mënyrë e thjeshtë për ta reduktuar këtë efekt është të trokitni lehtë në kanaçe në disa pika përpara se ta hapni.

Ideja është që trokitjet të ndihmojnë fluskat e gazit të zhvendosen dhe të rikthehen drejt pjesës së sipërme të kanaçes, në vend që të mbeten të shpërndara në lëng.

Sipas shpjegimit të paraqitur nga inxhinieri dhe krijuesi i përmbajtjeve Mark Rober, katër trokitje strategjike në kanaçe mund të ndihmojnë në uljen e rrezikut që pija të dalë me vrull kur hapet.

Ky parim nuk vlen vetëm për pijet e gazuara të tipit kola. I njëjti fenomen mund të ndodhë edhe me ujë të gazuar dhe pije të tjera që përmbajnë dioksid karboni.

Pse funksionon?

Çelësi është sjellja e fluskave të gazit.


Kur pija tundet, fluskat mund të krijohen dhe të shpërndahen brenda lëngut. Nëse kanaça hapet menjëherë, ulja e presionit shkakton çlirimin e shpejtë të gazit.

Trokitja e lehtë synon të ndihmojë në zhvendosjen e këtyre fluskave drejt pjesës së sipërme, duke reduktuar mundësinë që ato të shtynjë një sasi të madhe të lëngut jashtë kanaçes.

Pra, herën tjetër që një pije e gazuar është tundur gjatë transportit, nuk është e nevojshme të rrezikoni një "dush" me pije.

Disa trokitje të lehta në kanaçe, pak durim dhe një hapje e kujdesshme mund t'ju shpëtojnë rrobat nga njollat dhe tavolinën nga një rrëmujë e panevojshme.

Në fund të fundit, pas këtij truku të vogël fshihet një parim i thjeshtë i fizikës: kur ndryshon presioni, ndryshon edhe mënyra se si sillet gazi i tretur në lëng.





Të sugjeruara

Mbahet ceremonia e çmimeve "Emmy"/ Zbulohen fituesit për vitin 2026

Marrin kthesë hetimet për vdekjen e Mazonakis/ Çfarë u zbulua në telefonin e mjekes së arrestuar

FOTOLAJM/ Ishulli "magjik" i Tongos

Europa numër rekord fluturimesh gjatë verës/ Shqipëria, ndër destinacionet me rritje të lartë

Drama e Giorgos Mazonakis me familjen, shtrimi në psikiatri dhe vdekja e papritur

Shqipëria mes 3 destinacioneve të preferuara për vitin 2027

Foto/ Cllevio tregon politikanin e preferuar

Ndiqte këshillën e ChatGPT për të hequr kripën nga dieta, por përfundoi në spital me psikozë

Zhvillohet një patch i ri kundër puçrrave që duket se funksionon vërtet

6 vendet më të mira në Europë për pushime vjeshtore

5 pjesë në shtëpi që nuk duhen pastruar kurrë me uthull

I tregojnë ekspertët/ 6 rregulla për një shtëpi të pastër dhe të sistemuar

Me lot në sy, Ariana Granda tërhiqet nga jeta publike

"Mbi 200 llogari false"/ Beatrix Ramosaj shpërthen, rrjeti rikthen trekëndëshin me Borën dhe Donaldin

Mbaruan pushimet e verës/ Ja si të kapërceni melankolinë e kthimit në jetën e përditshme

Melania dhe Trump u shfaqën dorë për dorë, ekspertët analizojnë gjuhën e tyre të trupit

18 fakte të habitshme për yjet më të famshëm të muzikës pop

Ditëlindja e Luanës vjen me ulje të çmendura në "LULU"

Sondazhi i ri/ Nga europianët tek aziatikët, ja udhëtarët më të sjellshëm


Martesa që zgjatën vetëm pak ditë/ 10 çifte të famshme që vendosën ta fshinin martesën nga historia


[editorial](#)

14:40 Editorial Elvi FUNDO

Hashim Thaçi e la Kosovën të lirë/ Erion Veliaj nuk ndahet nga karrigia që i dha PS-ja

CNA LIVESTREAM





Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.